

The Franciscan archive residing in the library *Marin Barleti* in Shkodra

Abstract: *The following paper aims to bring into limelight a small part of the Franciscan archive which at present forms part of the “Marin Barleti” library in Shkodra.*

The paper succinctly highlights the story of this archive, how and why it now resides in the library. It also reports on the division of the material into categories.

The author aims to report on some manuscripts and typescripts by important Franciscan personalities such as Fr Shtjefën Gjeçovi, Fr Justin Rrota, Fr Benedikt Dema, Fr Pashko Bardhi and others. The paper undoubtedly sheds more light on the scientific research carried out by the Franciscan fathers and others in the field of the Albanian culture.

Ashtu siç vëren U.Eco, vlera e një punimi shkencor qëndron edhe tek citimet, si një mjet për të matur sasinë e materialeve që studiuesi ka bërë për të argumentuar trajtesën e tij.¹ Në rastin konkret trajtesa ka për të qenë krejt e veçantë, jo vetëm sa i takon paraqitjes të së shkuarës së depozituar², të Arkivit françeskan, por edhe faktit, që burimet e informacionit, në mungesë të burimeve të tjera alternative, do t’i përçasen veprës së Át Zef Pllumit: “Rrno vetëm për me tregue”.

“Kujtimet,- siç shkruan A.Plasari- do të na zbulohen, ashtu si eshtrat dhe si rropullitë që na zbulohen aq të afërta dhe njëkohësisht aq të huaja për ne vetë, që i ushqejmë dhe na ushqejnë. Sepse kujtimet nuk qënqeshin thjesht fakte jetësore³. Përtej këtij konkluzioni, kujtimet janë edhe materiale, që do t’i shërbejnë së pari studiuesve, “si dëshmi për të kuptuar se mohimi i së kaluarës, kulti i harresës, është një mënyrat më dinake për të përlegjur a posteriori gjithë sa ka pasur kriminale një rregjim”⁴

Në ditët e sotme në një botë komplekse, ku edhe kultura është e infektuar

1 Eco, U., *Pape Satàn Aleppe. Kronika të një shoqërie të lëngëshme*. Tiranë, 2017, f. 297.

2 Plasari, A., *Parathënie e botimit të parë*. Shih në: Pllumi, Z., *Rrno vetëm për me tregue*. Tiranë, 2006, f. 10.

3 Po aty, f.10.

4 Po aty, f.10.

nga shumë faktorë, “gjërat e vlerat”, më së shumti akoma nuk janë zbuluar ku ndodhen. Është detyrë imperative gjurmimi dhe evidentimi tyre. “Gjurmuesit” e dokumentave krenohen për zbulime të bëra në biblioteka dhe arkiva të botës, duke harruar se nuk është përfunduar plotësisht hulumtimi në institucionet tona të kulturës. I tillë është edhe një pjesë, ndonëse relativisht e pakët e fondit të njohur të françeskanëve, që ruhet në bibliotekën “Marin Barleti” të qytetit të Shkodrës. Nxjerrja në dritë e këtyre dokumentave arkivorë, ashtu siç shkruante Át Zef Pllumi: “.. *sa janë informuese aq janë edhe janë edhe*”⁵*përshkrime të zbehta të atij realiteti t’idhun historik që u zhvillue në Shqipni për gati 50 vjet.*

Lind pyetja: Si arriti një pjesë e fondit françeskan në bibliotekën e qytetit?

Si pronë e Bashkisë Shkodër, biblioteka i ka fillimet që nga viti 1929. Blerjet e pakta, por më tepër dhuratat e qytetarëve shkodranë, dhe të studentëve që studionin jashtë shteti bënë që në një periudhë të shkurtë, kjo bibliotekë të shquhet për pasurinë bibliografike dhe numrin e lexuesve.

Në vitet 1945-1946, fondet e saja u shtuan në mënyrë artificiale. Referuar Át Zef Pllumit: “*Ishte koha kur dhuna ishte ba pushtet*”⁶ *....ku legalet dhe ilegallet*⁷ *mes të tjerave i dhanë vetes të drejtën të shkatërronin dhe të grabisnin me dije dhe padije shumë objektet të kulturës t’artit*⁸.

Me një urdhër të 9 marsit 1946, të Komitetit Ekzekutiv të Shkodrës, e gjithë pasuria e tundshme dhe e patundshme e Kuvendeve që vepronin në Shkodër konfiskohej,⁹ mes tyre edhe arkivi dhe sistemi i bibliotekave françeskane.

Librat dhe dokumentat sipas shumë dëshmime gojore dhe të shkruara u keqtrajtuat, por fatmirësisht një pjesë e tyre, materiale të vyera të karakterit albanologjik, ngelën në bibliotekën e qytetit.

“Pasurimi i tretë”, u lidh me “*sihariqet komuniste*”¹⁰, të Revolucionit Kulturor Kinez, të sintezuara : “*në fjalimin mâ te çmendun të Enver Hoxhës*,”¹¹ mbajtur me 6 shkurt 1967, “*Për zhdukjen e besimeve të kota fetare dhe zakoneve prapanike*”¹².

Turma të eksituara njerëzish të të gjitha moshave, të yshtura nga dëshira për “*të djegë në zjarr dhe zhdukë nga faqja e dheut*”¹³, çdo gjë që

5 Pllumi, Z., *Rrno vetëm për me tregue*. Tiranë, 2006, f. 15.

6 Po aty, f. 35.

7 Po aty, f. 30.

8 Po aty, f. 26.

9 Peters, M. W.W. *Përballjet e historisë së kishës katolike në Shqipëri 1919-1926*, Tiranë 2010, f. 166

10 Pllumi, Z., *Rrno vetëm për me tregue*. Tiranë, 2006, f. 439.

11 Po aty, f. 439.

12 Po aty, f. 442.

13 Po aty, f. 441.

ishte pengesë në gjykimin e diktatorit, nën drejtimin e “*shtabeve të luftës kundër zakoneve prapanike e bestytnive fetare*”¹⁴, rishtazi, si në ditët e para të vendosjes së diktaturës, iu sulën përfaqësuesve, por dhe institucioneve fetare, duke rihapë proceset gjyqësore për ata klerikë që kishin ngelur, dhe duke shkatërruar e grabitë përsëri institucionet, dhe çdo gjë që i dilte para, mes tyre edhe arkivat dhe bibliotekat e mbetura.

Komisionet që do të seleksiononin “*të gjithë librat e dorëshkrimet me vlerë për ruajtje*”¹⁵, në përbërje të të cilëve fatkeqësisht, por edhe fatmirësisht, ndodheshin edhe njerëz të ditur, (një pjesë e të cilëve edhe kishin kaluar në kalvarin komunist- shën.im) u gjëndën “*...në kuvendin françeskan tek Arra e Madhe, ku jetonin tepricat e fundit t’asaj çete dijetaresh e artistash françeskanë, ... që ngryseshin ditët e veta Pater Marin Sirdani, Pater Justin Rrota, Pater Benedikt Dema*”¹⁶. Të tjera komisione vijonin punë edhe në *Arqipeshkvi*¹⁷, dhe në famullitë e Dioqezës.

E njëjta histori, por kësaj radhe më e disiplinuar. Proces-verbale të mbajtura pranë Degës së Punëve të Brëndshme të Shkodrës, listonin me qindra libra, por edhe dokumente arkivorë të françeskanëve dhe famullitarëve që depozitoheshin në bibliotekë; libra dhe dokumenta që në shumicën e rasteve mbajnë siglën e përdoruesit, por edhe të autorit, dedikime njerëzish të shquar, stampën e shtëpisë botuese, atë personale, por edhe të bibliotekës.

Librat shtoheshin, biblioteka pasurohej, bëhej e njohur në Shqipëri, si ndër më të pasurat, jo vetëm me njësi bibliografike. Me librat e sjellë, krijohej një fond i ri i cilësuar me emrin: “*i Perëndimit*”, ku edhe sot vijojnë të ruhen “*xhevahire*”, që presin së paku të njihen, pasi duke qenë pjesa më e madhe në latinisht, në mungesë të latinistëve, ngelen edhe sot fatkeqësisht, më së shumti vetëm “*njësi bibliografike*”. Ka patur raste të kemi ngritur edhe zërin, por si bibliotekarë kemi mësuar, dhe i kumtojmë edhe të tjerëve, se në bibliotekë duhet folur me zë të ultë, dhe sa më pak !?

Shpresojmë që këto libra, kjo pasuri intelektuale e njerëzve të shquar, për aq sa i shërbejnë kohës, të vihen në efencë. Në diktaturë leximi dhe konsultimi i tyre, duhej të kalonte përmes një filtri lejesh administrative. Fatkeqësisht edhe në ditët tona këto libra pak konsultohen, pengesë është mosnjohja e autorëve, por edhe e gjuhëve të huaja.

Arkivi françeskan

Kohë më parë duke rrëmuar në hapësirat e bibliotekës, u gjënda përballë disa arkave druri të mbyllura. Kishin vite që qëndronin ashtu. Më thanë se

14 Po aty, f. 442.

15 Po aty, f. 442.

16 Po aty, f. 296.

17 Po aty, f. 442.

ishin ca shkrime priftërinjsh. Pas hapjes së tyre u gjënda përballë një fond të vyer. Në një vështrim të parë, gjëndeshin në ata arka druri, dorëshkrime dhe daktilografime të ndryshme, emra të njohur françeskanësh, por ashtu edhe emra njerëzish të panjohur, fletore të mbushura me kaligrafi të ndryshe, të vështira për t'u lexuar, të tjera shkrimesh të vjetra shkodranësh, të pamundura për t'u lexuar, lutje të përshpirtshme, trajtesa të ndryshme folklorike, ditare personale dhe Kongregacionesh,etj.

Me nuhatjen e profesionit, kuptova, se nuk duhej ngutë në përshkrimin e këtij fondi. Duhej hulumtuar më tej për të gjetur ndonjë material referues, që siç shkruante U.Eco, mund të më rrëfenin për origjinën, historinë, për duart e panumërta, të atyre që i kanë shkruar, por edhe shfletuar, e më pas edhe për njollat e gishtërijve, vizatimet, shënimet në anëfaqe, nënvizimet, nënshkrimet ndër ballina, madje edhe vrimat¹⁸, damtimet e kohës, dhe të brejtësve.

Të trajtosh dhe më pas të përpunosh arkivin françeskan që ndodhet në bibliotekë, duhet patjetër të njohësh në thellësi veprën e Át Zef Pllumit: "*Rrno vetëm për me tregue*". Ai ishte padyshim jo vetëm njohësi më i mirë i kësaj pasurie më të madhe të llojit të saj në Shqipëri¹⁹, por nga ana tjetër, që në rininë e hershme, në ditët e vështira të terrorit komunist, sakrifikoji shumë: *„për arkivat, bibliotekat, muzetë e çdo gjë tjetër që mund t'i shërbente kulturës”*²⁰.

Arkivi në pjesën më të madhe i takon dy breza franceskanësh, kolosëve²¹ Pater Shtjefën Gjeçovit, Pater Gjergj Fishtës, Pater Pashko Bardhit, por edhe të *tepricës së fundit*²² personaliteteve të fushave filologjike, etërve Marin Sirdani, Justin Rrota, Benedikt Dema. Nuk mungon as vepra letrare e Pater Zef Pllumit, dorëshkrimi dhe daktilografimi i vëllimit poetik titulluar: "*Pllakat*", si dhe një pjesë e daktilografuar e librit të bërë gati për botim: "*Proza e Fishtës*".

Pjesa e arkivit që i takon "kolosëve françeskanë" - ashtu siç shkruante Át Zef Pllumi - rrjedh nga "*seleksionimi i gjatë për kohët e reja*"²³ i kryer nga ai, dhe Át Pal Dodaj. Në shqyrtimin me kujdes të arkivit ekzistues, pasqyrohet qartazi ndarja në grupe e dokumentave të bëra në Arkivin françeskan, që në vitin 1945. *Fletë jo të rëndësishme; dokumenta që përfshijnë çështje të Urdhërit dhe të Kishës; dokumenta që kanë të bëjnë me historinë, ekonominë, marrëdhëniet, kronikat ose ditarët, rregjistrat demografikë.... ; si dhe të gjitha dorëshkrimet e veprave të shkrueme prej autorëve të ndryshëm që*

18 Eco, U., *Pape Satàn Aleppo. Kronika të një shoqërie të lëngëshme*. Tiranë, 2017, f. 327.

19 Pllumi, Z., *Rrno vetëm për me tregue*. Tiranë, 2006, f. 40.

20 Po aty, f. 41.

21 Po aty, f. 296.

22 Po aty, f. 296.

23 Po aty, f. 43.

*njifen e nuk njifen*²⁴.

Edhe pjesa e ruajtur Arkivit françeskan të Kuvendit të Arrës së Madhe, veprat e Át Justin Rrotës, Át Marin Sirdanit dhe Át Benedikt Demës lidhen pazgjidhshmërisht me veprimtarinë e Át Zefit. Në vitin 1967, në kulmin e shtërngatës së re komuniste, si më i riu i fretërve, *u orvat t'i shpëtonte nga humbja, vjed hja dhe shpërdorimi veprat e tyre*²⁵, por edhe ata personale duke i *dërguar ndër miq*²⁶ krahas objekteve të tjera materiale. Por përpjekja qe e kotë.

Para trupit gjykues që e akuzonte për “tradhëti të naltë”²⁷, ai do të deklaronte: “*Mendova me i shpëtue, por jo, ata ranë të gjitha në dorën tuej. Kaq*”.²⁸

Gjykata e popullit për herë të dytë në vitin 1967, e dënonte me 25 vjet burg duke ia konfiskuar *gjithshkafë*²⁹ që i përkiste, përfshirë edhe librat.

Në arkivin e bibliotekës “Marin Barleti” të Shkodrës, gjendet një proces-verbal që mban datën, 21.X.1970. Në të lexojmë: “I mbajtur në Bibliotekën e Shtetit për marrjen në dorëzim nga Dega P. Mbrendëshme të materialeve të poshtëshënuara, konfiskue të dënuemit P. Zef Pllumi.

Është një listë e gjatë në të cilën përfshihen, rreth 160 njësi, të mbledhura dhe të sistemuara në 21 dosje, që përmbajnë korespondenca, folklor, etnografi, studime gjuhësore dhe historike, krijimtari letrare, dorëshkrime origjinale të Fishtës, Gjeçovit, Sirdanit, Rrotës, D'Istrias, e sa të panjohurve. Fatkeqësisht nga tërësia e njërive të shënuara në proces-verbal, një pjesë kanë lëvizur drejt institucioneve të tjera, apo kushedi se ku..!³⁰

Ky konstatim bëhet më interesant edhe për faktin se vetë Át Zef Pllumi, mesa duket nuk ka patur njohuri mbi ekzistencën e një pjese të Arkivit Françeskan në bibliotekën “Marin Barleti”. Siç vërehet, bibliotekarët që u morën me trajtimin e fondit për shumë arsye, që në ditët e sotme është e vështirë për t'i kuptuar (pasi disa edhe kanë vdekur- shën.im) i kanë mbajtur të mbyllura këto materiale arkivore. Ndoshta mund t'i kenë gjykuar edhe si shumë të çmuara !

Duke vijuar arsyetimin, në vitin 1998, Át Zef Pllumi, në një artikull rreth veprës “*Vatikani dhe Arbëria*”, të Gjergj Gashit, shkruan: “*Unë personalisht qysh në rininë e parë kam punue në Arkivin Françeskan, i cili, sot, edhe pse i cunguem, përban bërthamën e Arkivit Historik Shtetnor*”³¹. Në gjykimin tim

24 Po aty, f.43.

25 Po aty, 505.

26 Po aty, f.478.

27 Po aty, f.517.

28 Po aty, f. 515.

29 Po aty, f.518.

30 Çuni, Gj., *Dashunia për librin, “Krim kundër shtetit”. Hylli i Dritës*. In Memoriam At Zef Pllumit. (2008), 1, 59.

31 Pllumi, Z., *Ut Heri dicebamus... Siç thoshin dje... (Histori kurrë e shkrueme)*. BF, 2017, f. 143.

konstatohet, që Patër Zefi është nisur edhe nga fakti që Arkivi historik i “Hyllit të Dritës”, mendoj të jetë i depozituar tërësisht në Arkivin e Shtetit. Si një njohës i afërt i At Gjon Shllakut dhe i Arkivit historik të “Hyllit”, mund të ketë konsultuar në vijim, ashtu siç shprehej ai vetë, *pasurinë e pamasë të dokumentave të Rilindjes Kombëtare bashkë me shkrimet, letrat, kujtimet e dorëshkrimet e Luigj Gurakuqit, Hasan Prishtinës, Imzot Doçit, Luigj Bumçit e shumë burrave të tjerë t’atdheut*³² duke kufizuar njohuritë mbi Arkivin Françeskan, vetëm tek Arkivi i “Hyllit të Dritës”, i vendosur në Tiranë ku edhe shërbente.

Ja pra, mesa kuptohet At Zef Pllumi, nuk kishte njohuri, që një pjesë e librit “*Proza e Fishtës*” e mbledhur dhe përgatitur për shtyp nga vetë ai, që do të përdorej nga hetuesit si alibi për t’ia shtuar akuzës, ndodhej në bibliotekë. Nuk kishte dijeni as për vëllimin tjetër poetik në dorëshkrim dhe daktilografim “Pllakatat”.

As At Benedikt Dema, nuk pati njohuri mbi ekzistencën në bibliotekën “Marin Barleti” të tre veprave në dorëshkrim dhe të daktilografuara mes të cilave, veprën: “Fjalor i shtjelluem i gjuhës shqipe, sistemue përmes metodit ideologjik-praktik”, të vitit 1953; ndërkohë që Justim Rrota dhe Marin Sirdani kishin vdekë.

Më poshtë do të rreshtoj disa nga njësitë më të vlerata që mban ky arkiv, por nuk mund të lë pa nënvizuar edhe fakte të tjera të përmendura, nga At Zef Pllumi, të cilat reflektohen edhe në gjëndjen e tij të sotme.

* arkivi vijon të jetë i pasisteluar sipas *kritereve shkencore të përpunimit arkivor*.³³

* në arkiv gjenden dokumenta, trajtesa të ndryshme letrare, ditare dhe shënime historike, me stile të ndryshme shkrimi, që me të drejtë për të tilla shkrime, ai shprehej: “*njeriu nuk i merr vesht fjalët e shpesh here as gërmat*”³⁴.

* arkivi përmban dokumenta edhe në gjuhën italiane, por nuk mungojnë as ata me shkrime turke, mbasi siç shprehej frati, *kemi të përbashkët një histori pesëqindvjeçare*³⁵

Njësi të vlerata

Në tërësi gjëndja e sotme e arkivit përbëhet nga 154 njësi, nga të cilat 85 njësi, janë dorëshkrime. Të identifikuar janë punimet e 14 autorëve.

Nga ata mund të veçojmë:

At Gjergj Fishta. Dorëshkrime origjinale të dy kangëve të “Lahutës”, si dhe të një kapitulli të “*Gomarit të Babatasit*”.

32 Pllumi, Z., *Rrno vetëm për me tregue*. Tiranë, 2006, f. 43.

33 Po aty, f.40.

34 Po aty, f.39.

35 Po aty, f.40.

At Shtjefen Gjeçovi. *Arkiv i Kishës së Prekalit; Paradia e popullit; Dera dhe brezat e Dukagjinëve; Shënime historike; Shënime të Kanunit të L.Dukagjinit. Copëza shënimesh historike*.

At Pashk Bardhi. *Ditar (Krahina e Mirditës në vitet 1904-1913)*

At Justin Rrota. Ka 18 njësi, punime gjuhësore, por edhe fetare, letrare, libra për fëmijë, tematikë historike etj. E rëndësishme për këtë fond është plotësimi i saktë i bibliografisë së veprave të autorit, si dhe botimi i disa veprave, mes të cilave do të veçoja: *"Çilsit i Parrizit ase premtimi i majtun", "Epigrame" dhe "Ditari i një t'smuti"*. Të gjitha veprat e J. Rrotës janë të daktilografueme, me makinën "Olivet", dhe mbajnë aprovimin e Arqipeshkvit të Shkodrës, Imzot Ernesto Çoba.

At Benedikt Dema. *"Fjalor i shtjelluem i gjuhës shqipe sistemue përmes metodit ideologjik-praktik"*; dorëshkrim i vitit 1953 që mendoj të jetë një prej pesë vëllimeve të kolanës: *"Fjaluer Enciklopedik", "Himnologjia kristiane" (daktilografim), Diftojësi alfabetik i katër blejve të parë"*.

Marin Sirdani. *Skenderbeu sipas gojëdhënave (dorëshkrim). Treg varzash (novelë), Autobiografi personale*.

At Zef Pllumi. *"Proza e Fishtës" (daktilografim); "Pllakata" (daktilografim dhe dorëshkrim)*

Dom Prend Suli. *"Folklore e martesë në Bizë" (dorëshkrim)*

Të tjera. Refik Toptani. *"Një hije e zezë e derës së Toptanëve ase Esad Pasha" (dorëshkrim)*

"Shkodranishtja e moçme" (dorëshkrim i vitit 1874)

"Letërkëmbim" i Dora D'Istrias etj.

Në përfundim më të drejtë pasuria arkivore e françeskanëve, por edhe e klerit katolik është pasuria e atyne që vdiqën njerëz, atyne që qëndruan njerëz gjatë asaj periudhe të vështirë në të cilën njeriu u shndrrue në kafshë pune (At Zef Pllumi).

Bibliografi

Çuni, Gj. *Dashunia për librin, "Krim kundër shtetit". Hylli i Dritës. In Memoriam At Zef Pllumit*. (2008), 1

Eco, U., *Pape Satàn Aleppo. Kronika të një shoqërie të lëngëshme*. Tiranë, 2017.

Peters, M. W.E. *Përballjet e historisë së kishës katolike në Shqipëri 1919-1926*, Tiranë 2010

Plasari, A., *Parathënie e botimit të parë*. Shih në: Pllumi, Z., *Rrno vetëm për me tregue*. Tiranë, 2006

Pllumi, Z., *Rrno vetëm për me tregue*. Tiranë, 2006

Pllumi, Z., *Ut Heri dicebamus... Siç thoshin dje... (Histori kurrë e shkrueme)*. 2017.